



Kom.Dh.Shk.II.nr.389/2022

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj – Sheremeti dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit shoqëria tregtare “T...” sh.p.k, me seli ne Prishtinë, e përfaqësuar nga E.K, avokate në Fushë Kosovë, kundër të paditurës shoqëria tregtare “A...”, LLC me seli ne Prishtinë qe sipas autorizimit përfaqësohet E.A, avokat nga Prishtina, në çështjen juridike lidhur me pengimin në posedim, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala paditëse përmes te autorizuarës se saj, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.2212/2019, të datës 03.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 01.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa paditëses “T...” sh.p.k, me seli ne Prishtinë, ashtu që ANULOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.2212/2019, i datës 03.02.2021, dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe rivendosje, Gjykatës Komerciale, Dhomës se Shkallës se Parë .

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar, C.nr.2212/2019, të dt. 03.02.2021, ka vendosur si vijon:

“Refuzohet në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditëses shoqëria tregtare ‘T...’ shpk me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të ‘vërtetohet se e paditura e ka penguar paditësen në shfrytëzimin e kufirit verior të ngastrës 10108-0, sipas kufirit të drejtë në gjatësinë e frontit 4.54m; në kufirin 2-3, 16.45m; në kufirin 3-4, në 37.49m; pastaj 4-5, me 1.19m; 5-6 me 8.47m; 6-7 me 14.56m; 7-8 me 19.86m dhe 8-1 me 10.97m; të obligohet e paditura që të ndalë pengimin e posedimit të ngastrës së paditësit si dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet procedurale dhe atë 405euro për tri seanca gjyqësore (nga 135 euro për çdo seancë), 104 euro për përpilimin e padisë dhe 150 euro për ekspertizën e gjeodezisë.

Obligohet paditësja që të paditurës ‘A...’, LLC, me seli në Prishtinë, t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në lartësi të përgjithshme prej 374 euro”.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e autorizuar e paditëses, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar

apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dyte, ta aprovojë ankesën në tërësi si të bazuar, ashtu që të ndryshoj aktvendimin e shkallës së parë dhe të aprovojë kërkesëpadinë e palës paditëse në tërësi si të bazuar apo ta anulojë aktvendimin e ankimuar dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktvendimi nuk ka ushtruar ankese pala e paditur, e as përgjigje në ankesën e palës paditëse.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 dhe 195 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, gjeti se:

- Ankesa e të autorizuarës së palës paditëse është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja shoqëria tregtare "T..." sh.p.k, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga E.K, avokate në Fushë Kosovë, me dt.04 korrik 2019 ka parashtruar padi kundër të paditurës kompania e re D... te H..., me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit pengimin e posedimit, me propozim për caktimin e masës siguroese, ndërsa në seancën e datës 29.01.2021 ka bërë precizimin padisë dhe kërkesëpadisë në kuptim subjektiv dhe objektiv.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, ka nxjerr aktvendimin e ankimuar C.nr.2212/2019 të datës 03.02.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të tij. Në arsyetim të aktvendimit gjykata në fjalë ka theksuar se nga provat e administruara ka rezultuar se nuk është provuar fakti se paditësja ka pasur pushtetin e fundit faktik mbi pjesën e ngatrrës kontestuese përkatësisht është vërtetuar fakti se paditësja asnjëherë nuk ka qenë në posedim të pjese se ngastrës lëndore me tej gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e atakuar ka konstatuar se sa i përket paluajtshërise lëndore gjendja faktike nuk përputhet me gjendjen juridike, pasi që një pjesë e ngastrës është e evidentuar në emër të paditëse, për kundër që nuk ka qenë në posedim të saj. Me aktvendimin e atakuar gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe nga parashtrimet e palës paditëse, e në veçanti nga pretendimet e saja nuk ka arritur të vërtetoi faktin e afatshmerise se padisë, pasi që nga provat e administruar ka vërtetuar se paditësja asnjëherë nuk e ka pasur në posedim pjesën e ngastrës kontestuese, e mbi këtë bazë nuk është vërtetuar as mënyra e kryerjes se pengim posedimit Bazuar në këto konstatime, duke iu referuar dispozitës nga neni 103 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtave tjera Sendore, ka vendosur që padia e palës paditëse të refuzohet si e pabazuar. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dyte nuk mund të pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm një vlerësim të tillë juridik të Gjykatës së shkallës së parë, pasi aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) të LPK, sepse dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktvendimit, përkatësisht të njëjtit i mungojnë arsyet mbi faktet vendimtare mbi bazën e të cilave gjykata ka vendosur për themelësinë e kërkesëpadisë së paditëses.

Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka vendosur ta refuzoi padinë e paditësit por pa i shtjelluar të gjitha faktet relevante në procedure, për më tepër që nuk është sqaruar as aspekti

i prekludimit të së drejtës së paditësit ne raport me kërkesën e bërë, pasi që arsyetimi i gjykatës të shkallës së parë nuk përmban arsye përkitazi me afatshmërin e padisë, nuk është konstatuar periudha kohore kur pretendohet të ketë ndodhur akti i pengim posedimit

Pra nga shikimi në shkresat e lëndës nuk mund të kuptohet se në cilat prova është bazuar gjykata e shkallës së parë kur e ka vlerësuar prekludimin e padisë së paditësit, pasi që nga shkresat e lëndës ky fakt rezulton të mos jetë sqaruar. Gjykata e shkallës së dytë rikujton se afatet tek pengim posedimi janë afate ligjore me karakter prekluziv, të cilat prodhojnë pasoja për palët, andaj për të qenë në gjendje që këto afate të llogariten drejtë, duhet që gjykata për të njëjtat të ketë prova konkrete. Në të kundërtën gjendja faktike do të mbetet e pa vërtetuar drejtë dhe në mënyrë jo të plotë, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret, për çka edhe pretendimet ankimore të paditëses, më rastin konkret janë vlerësuar të jenë të bazuara. Andaj mbi bazën e të lartëkurave, për gjykatën e shkallës së dytë gjendja faktike në këtë procedurë nuk del të jetë e vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, për çka aktvendimi i i ankimuar u deshtë të prishet sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka pasur mundësi që vetë të vendos vetë për çështjen *in meritum*.

Bazuar në nenin 114 të Ligjit të për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore parashihet se *“Kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi që poseduesi e marrë dijeni lidhur me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit.”*

Si rezultat i gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë jo të plotë dhe jo të drejtë, edhe e drejta materiale në këtë çështje kontestimore nuk është zbatuar drejtë. Megjithatë, duke i marrë për bazë shkeljet e konstatuara si më lartë të natyrës procedurale, si dhe vërtetimin jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike në këtë procedurë, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se tani për tani nuk janë krijuar kushtet ligjore që eventualisht aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të mund të ndryshohet, por është dashur që i njëjti të prishet dhe që lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje. Gjykata e shkallës së dytë, rikujton faktin se gjykatat (e faktit) gjykojnë dhe vendosin në bazë të Kushtetutës, ligjeve dhe akteve të tjera të cilat kanë qenë në fuqi në momentin e realizimit të raportit të pretenduar juridiko civile, si dhe bindjes së lirë të gjyqtarit të formësuar mbi bazën e gjendjes faktike të provuar në një procedurë, me çka jetësohet edhe silogjizmi gjyqësor si një formë e përfundimit logjik deduktiv në një procedurë gjyqësore. Detyrë e gjykatës është të zbatoj ligjet në fuqi, në pajtim me faktet dhe gjendjen faktike të vërtetuar dhe që këto fakte eventuale të provuara me prova konkrete t’ia përshtatë normës përkatëse ligjore, e jo që vetëm t’i përmendë faktet, provat dhe dispozitat ligjore, në ndërkohë që nuk e bën lidhjen në mes të tyre për ta jetësuar silogjizimin gjyqësor. Për këto arsye vendimi gjyqësor i ankimuar paraqitet të jetë i pakuptueshëm, i mangët dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 160 të LPK, për çka edhe u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimin.

Nga arsyet e cekura si më lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të sipërcituara, për çka e njëjta udhëzohet që në riprocedurë t’i ketë parasysh këto lëshime dhe vërejtjet e bëra në lidhje me to, ashtu që të ndërmerre veprime përkatëse për përgatitjen e gjykimit duke vlerësuar paraprakisht të gjitha kushtet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit, të kërkoj nga pala ta precizoj kërkesëpadinë e saj, duke e saktësuar kohën e ndodhjes së aktit të pretenduar të pengim posedimit, të konstatoj mënyrën e ndodhjes së aktit të pengim posedimit. Gjykata e shkallës së parë duhet të

ftoj palën paditëse që plotësimin dhe korigjimin e padisë të bëjë nën kërcënim të lëshimit në kuptim të nenit 102 të LPK-se, duke caktuar afatin kohor - ligjor për korigjim dhe varësisht nga veprimet e palës paditëse të veproj në pajtim me këtë dispozitë ligjore (pra neni 102 të LPK-se).

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në procedim të serishëm të evitojë të metat e sipërpërmendura, në atë mënyrë që fillimisht nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse të vërtetojë momentin kur pretendohet të jetë kryer akti i pengimit të posedimit, e më pas të vlerësojë çështjen e afatshmërisë së padisë, po ashtu të vërtetojë mënyrën e ndodhjes së pengimit të posedimit si dhe rrethanat tjera me rëndësi për procedim të mëtutjeshëm dhe vendosje në këtë çështje juridike kontestimore, gjithnjë duke proceduar në përputhje me dispozitat në fuqi të ligjit për procedurën kontestimore si dhe duke e aplikuar në mënyrë të drejtë ligjin material. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë.

Meqenëse aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është prishur në pikën I të dispozitivit të tij, atëherë domodoshmërisht është dashur të priset edhe pika II e dispozitivit të tij, e cila ka të bëjë me shpenzimet procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet të vendosë sërish në procedurën e rigjykimit, sado që të jenë ato.

Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata e Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i atakuar duhet të anulohet, dhe çështja të kthehet në procedim të sërishëm.

Në bazë të rrethanave të lartpërmendura, e në mbështetje të dispozitave të nenit/ve 195.1 pika c, 208, dhe 209 pika d) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE - Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.389/2022, me datë 01.09.2022

Gjyqtari,
Faton Bajrami d.v.